

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Puna e kësaj drejtorie ka konsistuar në zbatimin e detyrave që dalin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) i cili ka reflektuar detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Bazuar në sa më sipër prioritetet tona në terma afatshkurtër dhe afatgjatë respektivisht janë:

- Marrja e masave për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe çertifikimit dhe rëndësisë së tyre në tregtinë ndërkombëtare;
- Sigurimi i kapaciteteve administrative për të zbatuar MSA;
- Progres i mëtejshëm në adoptimin e standardeve europiane dhe rritje e përpjekjeve për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në CEN&CENELEC;
- Përmirësimi i funksionimit të DPS si Organi Kombëtar i Standardeve, duke aplikuar praktikat më të mira europiane.

Ç'farë është realizuar gjatë këtij viti:

Përafrimi i legjislacionit

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së dhe bazuar edhe nga sa parashikohet në PKZMSA, në Shkurt të këtij viti u miratua ligji nr.9870, datë 04.02.2008 "Për Standardizimin".

Për përgatitjen e këtij ligji DPS është mbështetur në përcaktimet e dhëna në dokumenta Europiane e Ndërkombëtare, në parimet dhe rekomandimet e KE-së.

Miratimi i këtij ligji ka krijuar hapsirat e nevojshme ligjore për një funksionim efektiv të sistemit kombëtar të standardizimit në përputhje me praktikat europiane në këtë fushë dhe ka përmbushur progresin e kërkuar në kuadrin e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së, si dhe detyrimeve në kuadër të MSA.

Gjithashtu, miratimi i ligjit kërkon rishikimin e të gjitha Vendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, të cilat u ripunuan dhe janë dërguar ne METE, si vijon:

Projektvendimi "Për shkëmbimin e të dhënave në fushën e standardeve, rregullave teknike dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit" në të cilën janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e DPS në zbatim të Marrëveshjes së OBT mbi Barrierat Teknike në Tregti;

Projektvendimi "Për zbatimin e masave sanitare dhe fitosanitare" në të cilën janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorise apo sektorit përkatës në Ministrinë e

Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në zbatim të Aneksit B – Transparenca për rregulloret sanitare dhe fitosanitare - Marrëveshjes së OBT për Zbatimin e Masave Sanitare e Fitosanitare;

Projektvendimi “Për Kodin e përgatitjes, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve”, i cili ngarkon DPS me detyrën e zbatimit të parashikimeve të dhëna në Aneksin 3 të Marrëveshjes së OBT mbi Barrierat Teknike në Tregti;

Projektvendimi “Për krijimin, përbërjen, kompetencat dhe funksionimin e Bordit Drejtues të DPS”, i cili përcakton përbërjen, funksionet dhe kompetencat e Bordit, funksionet e kryetarit të tij, organizimin e mbledhjeve, marrjen e vendimeve dhe të drejtën e votës, etj.

Projektvendimet janë dërguar në METE dhe janë në fazë diskutimesh me drejtoritë teknike përkatëse.


Gjithashtu, po rishikohet dhe po bwhen ndryshimet e duhura nw rregulloren e brendshme e DPS si dhe procedurat e punës për sejcilin pozicion pune, që janë pjesë e sistemit tonë të cilësisë.

U bë analiza e Progres Raportit të BE-së për fushën e Standardizimit, ku megjithë arritjet e përmendura në raport kishte edhe rekomandime e këshilla të cilat do të jenë prioritet i punës sonë gjatë 2009 e në vazhdim.


Adoptimi i standardeve Europiane.

Në zbatim të PKZMSA, deri në fund të vitit 2008 DPS kishte planifikuar të adoptojë si standarde shqiptare 80% të totalit të standardeve EN të të dy organizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC, ndërkohë që janë adoptuar 88.8% të tyre Gjatë vitit 2008 janë ratifikuar gjithsej 4066 standarde dhe dokumente standardizimi, nga të cilat 2765 janë standarde evropiane.

Grafiku i mëposhtëm paraqet gjendjen aktuale të Standardeve Shqiptare dhe strukturën sipas llojeve:



Struktura e standardeve S SH ka një përmirësim të dukshëm, në favor të standardeve evropiane të adoptuara, S SH EN, si paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
S SH të pastra	3557	3558	3558	3563	3565	3520	3487	3359	3332
Adoptime	1281	2408	3479	5002	6525	9070	11860	14952	17443

Vitet e fundit, është rritur ritmi vjetor i adoptimit të standardeve të huaja si standarde shqiptare, gjë që vihet re qartë në grafikët e mëposhtëm:

Këtë vit është punuar intensivisht për adoptimin 100% të standardeve të harmonizuara, si dhe për përditësimin e tyre në se ka ndryshime.

Gjendja, sipas mënyrës së adoptimit të standardeve të huaja (me përkthim të plotë, me faqe të parë, dhe me listë), në fund të vitit 2008 është e njëjtë me vitin 2007, mbasi nuk është përkthyer asnjë standard i ri, paraqitet si më poshtë:



Gjatë këtij viti janë shfuqizuar 30 standarde të pastra shqiptare, të cilat konfliktojnë ose jo me standardet EN të adoptuara, si dhe 652 standarde S SH EN dhe S SH ISO, të shfuqizuara nga organizmat përkatëse.

Këtë vit janë aktivizuar dhe funksionuan rregullisht 40 Komitete Teknike, dhe janë bërë 130 mbledhje të tyre, në të cilat u diskutuan dhe u miratuan gjithsej 4066 standarde dhe dokumente standardizimi. Në këtë aktivitet janë përfshirë mbi 100 specialistë me përvojë të fushave të ndryshme.

Gjatë këtij viti gjithashtu:

U bë riorganizim i Komiteteve Teknike, në përputhje me KT të CEN dhe CENELEC.

U punua për plotësimin me të dhëna të tjera të database të standardeve.

Për përmirësimin e mëtejshëm të punës, në arkivën elektronike, këtë vit janë shtypur dhe formatuar 120 standarde të pastra shqiptare (në total janë shtypur 1020 standarde)

Puna e DPS është e orientuar në drejtim të plotësimit të 9 kushteve. Procedurat e DPS, vazhdojnë të rishikohen dhe permiresohen, duke u përputhur me ato të CEN/CENELEC.

Eshte punuar dhe per evidentimin e nevojave per permiresimin e data-base tonë, gjithashtu që të jemi të aftë të ndjekim punën e këtyre organizmave.

Një tregues tjetër pozitiv, në këtë drejtim, është ritmi i adoptimit të standardeve EN, si dhe përpjekja për shfuqizimin e standardeve konfliktuale.

Duke u nisur nga prioritetet e DPS, një rëndësi e madhe i është dhënë promovimit të rëndësisë e përfitimeve që ka përdorimi i standardeve europiane nga prodhuesit vendas dhe subjektet publike.


Faqja e internetit

Faqja e internetit www.dps.gov.al, është pasuruar me informacione të ndryshme në formën e të rejave njoftimeve, artikujve etj.

Ngjarjet më të rëndësishme të vitit për DPS janë pasqyruar në këtë faqe, duke përfshirë kontrata, takime, konferenca, paketa të reja standardesh, buletine informative, katalogun e standardeve etj. Kjo faqe është përgatitur edhe në anglisht, ku jepet informacion rreth DPS-s dhe mënyrës së organizimit të sistemit të standardizimit në Shqipëri. Gjithashtu, në këtë faqe të interesuarit mund të gjejnë edhe Katalogun e Standardeve Shqiptare të 2008 në anglisht, ku është edhe udhëzuesi përkatës i përdorimit në gjuhën angleze në linkun: http://www.dps.gov.al/dponline/search_eng.php?gj=Eng si dhe Buletinët informativë periodikë të publikuara gjatë vitit.

Janë përgatitur dhe publikuar një sërë artikujsh në lidhje me të rejat më të fundit në fushën e standardizimit. Këto artikuj kanë pasur si qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë për rolin që luajnë standardet.

Kartolina elektronike e Vitit të Ri, e personalizuar për DPS-në, e cila u shpërnda elektronikisht. Kjo kartolinë e personalizuar është vendosur edhe në faqen e internetit të DPS-s. Numërohen rreth 3061 klikime në faqen kryesore të DPS dhe rreth 7000 vizitorë që kanë klikuar ndërfaqet dhe rubrikat e tjera të saj. Kohëzgjatja mesatare e çdo klikimi është 3.20 minuta. Grafiku i mëposhtëm tregon rritjen e interesit gjatë 2008:



Artikuj

Janë përgatitur dhe publikuar në faqen tonë të internetit një numër artikujsh mbi standardet ISO 15270, i cili jep specifikime mbi riciklimin e materialeve plastike, ISO 13823 i fushës së ndërtimit, EN ISO 14001 mbi kontrollin dhe përmirësimin e performancës së mjedisit për operatorët, ISO 22000 dhe ISO 22005 në fushën e ushqimit, si dhe një numër artikujsh të botuara në Gazetën "*proBiznesi*" dhe Revistën "*Monitor*" disa nga të cilat janë - Standardet, implementimi dhe siguria në punë; - ISO 9001:2008 standardi i ri për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë; - Standarde menaxhimi, vetëm me detyrim; - Konkurrenca rrit

certifikimin e kompanive; etj, njoftime për shtyp dhe artikuj për Ditën Botërore të Standardeve, 14 Tetori 2008, ku në qendër të vëmendjes për këtë vit edhe në nivel ndërkombëtar ishin standardet e ndërtimit për të patur ndërtesa të forta e të qëndrueshme.

Buletinet

Në kuadrin e sigurimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në aktivitetin e standardizimit një nga elementët është edhe publikimi i Buletineve periodike të DPS. Gjatë këtij viti janë publikuar 4 buletine (nr. 34, 35, 36, dhe 37). Publikimi i buletineve është bërë në letër, është dërguar në ministritë dhe kompani, firma apo individë privatë elektronikisht dhe gjenden online në faqen e internetit, duke dhënë një informacion të hollësishëm për standardet e sapo adoptuara, standardet e shfuqizuara dhe duke kërkuar mendimin publik për ato standarde që kanë statusin e draft-standardeve.

Publikimi i katalogut

Katalogu i Standardeve Shqiptare është një tjetër element i parimeve të standardizimit mbi sigurimin e transparencës, i cili përmban të gjitha standardet puro shqiptare në fuqi, ato të adoptuara si dhe standardet e shfuqizuara dhe botohet çdo vit. Katalogu i Standardeve Shqiptare 2008 është shpërndarë gjatë vitit në format letër dhe me CD. Gjithashtu, ai është vendosur edhe në faqen e internetit të DPS <http://www.dps.gov.al/dpsonline/search.php?gj=Al> sëbashku me udhëzuesit e tij të përdorimit në shqip dhe anglisht.

Aktivitete të organizuara

U organizua takimi për Ditën Botërore të Standardeve, 14 Tetori 2008, ku morën pjesë mbi 60 persona dhe ku lektorët ishin vendas dhe të huaj. Celebrimi i kësaj dite këtë vit iu kushtua standardeve të fushës së ndërtimit për të patur ndërtesa të forta dhe të qëndrueshme në kohë dhe të standardeve të elektroteknikës të cilat përdoren për rrjetet dhe pajisjet e ndërtesave.

Marrëveshjet

Gjatë këtij viti DPS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Agjensinë Rajonale të Zhvillimit në Tiranë, me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë. Këto marrëveshje janë të rëndësishme për DPS sepse tentojnë përfshirjen e biznesit në procesin e standardizimit, rritje të promovimit dhe rëndësisë që ka përdorimi i standardeve Europiane e ndërkombëtare, rritje të përdorimit të këtyre standardeve nga biznesi vendas dhe për rrjedhojë edhe rritje të të ardhurave të DPS nga shitja e standardeve. Gjithashtu, është përgatitur dhe rënë dakord në parim Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institutin e Standardizimit të Republikës së Maqedonisë (ISRM).

Publikimet

Janë shpërndarë gjatë vitit publikimet dhe broshurat e përgatitura nga DPS, disa nga të cilat janë dhënë si vijon:

- Katalogë të Standardeve Shqiptare 2008 në format letër dhe CD;

- Buletinët informativë periodikë të DPS në format letër dhe elektronikisht me e-mail;
- Fletëpalosje të DPS;
- Fletëpalosje mbi Direktivat e New Approach-it;
- Broshura mbi Përfitimet nga përdorimi i standardeve;
- Standardizimi një garanci më shumë;


Përmirësimi i kushteve për klientët

Është përmirësuar mjedisi i pritjes së vizitorëve/ klientëve në DPS, në të cilin janë vendosur stenda me materiale promovuese dhe informuese si dhe është vendosur një monitor (*screen*) ku janë paraqitur në formën e slide-ve apo njoftimeve materiale të ndryshme informuese e promovuese ku përfshihen artikuj mbi standarde, informacion rreth DPS, një material informues mbi ligjin e ri të standardizimit, njoftime mbi aktivitete në organizim, materiale shpjeguese se çfarë është një standard, pse adoptojmë standardet europiane e ndërkombëtare, etj.

Shitja e standardeve

Si rezultat i një pune intensive në drejtim të ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas gjatë këtij viti janë shitur gjithsej **1404** standarde (përkundrejt **1137** standardeve në 2007) ose e shprehur në përqindje 24% më shumë se sa viti 2007, nga të cilat për këtë vit **1145** standarde janë standarde Europiane dhe ndërkombëtare (S SH EN dhe S SH ISO/IEC), dhe vetëm standarde Europiane (S SH EN) janë **1043** përkundrejt **789** standardeve S SH EN që janë shitur gjatë 2007. Shitja e standardeve shqiptare S SH është bërë sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve 10 dhe 12 të CEN&CENELEC dhe marrëveshjeve ndërkombëtare (midis organizmave të standardizimit).


Grafiku i mëposhtëm jep gjendjen e shitjeve për sejcilën kategori standardesh:



St.2008	S SH EN	S SH ISO	S SH	Totali
---------	---------	----------	------	--------


Nr.	1043	115	246	1404
-----	------	-----	-----	------

Totali i standardeve të shitura gjatë 2008 dhe standardet me origjinë europiane (S SH EN) krahasuar me 2007 jepen si vijon:



Viti	S SH EN	Totali
2007	789	1137
2008	1043	1404

Zbatimi i standardeve europiane në produktet dhe shërbimet vendase ka një rritje të dukshme, e cila tregohet edhe nga grafiku në vijim ku standardet puro shqiptare (S SH) zenë një vend të pakonsiderueshëm në shitjet e realizuara gjatë këtij viti:




Viti	S SH EN	S SH
2008	1043	246

Nga shitja e këtyre standardeve janë krijuar të ardhura në shumën prej **4.090.000*** lekë ose 90% më shumë krahasuar me vitin 2007 (**2.191.699** lekë). Gjatë këtij viti blerësit kanë qenë 27 nga sektori publik dhe 42 nga ai privat.

Standardet më të shitura për vitin 2008 kanë qenë **standardet e fushës së ndërtimit dhe menaxhimit të cilësisë.**

Grafiku i mëposhtëm jep ecurinë e të ardhurave nga shitja e standardeve krahasuar me 2007 (e shprehur në lekë):




Notifikimet

Lidhur me detyrimet që kemi si Pikë Referimi e OBT, gjatë këtij viti janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet anëtare të OBT, në të gjithë ministrinë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë. Më shumë notifikime të huaja kemi patur nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Duhet theksuar se komunikimi me këtë ministri dhe me ministrinë e tjera të linjës përsonale i përket notifikimeve dhe kërkesave për informacione të ndryshme që lidhen me fushat që ministrinë mbulojnë është i mirë.

Gjatë këtij viti janë bërë **10 notifikime shqiptare (TBT)** të projekt ligjeve të ardhura nga ministrinë e linjës dhe janë ndjekur me korrektësi të gjitha komentet e ardhura nga subjekte të ndryshme në lidhje me këto notifikime dhe **54 notifikime janë kryer lidhur me projekt aktet ligjore e nënligjore apo urdhërat e Ministrisë të MBUMK që kanë të bëjnë me masat sanitare e fitosanitare (SPS).**


* Disa nga subjektet që kanë blerë standardet kanë qenë bashkëpunëtorë të DPS-së dhe çmimi i aplikuar për to ka qenë 50% e çmimit të standardeve.

Grafiku i mëposhtëm jep notifikimet e kryera gjatë 2008:



Gjithsej, që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së OBT janë bërë 134 notifikime nga të cilat 36 janë notifikime të projekt akteve ligjore e nënligjore që kanë ndikim në mos krijimin e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare (TBT) dhe 98 notifikime janë lidhur me projekt aktet ligjore e nënligjore dhe Urdhërat e Ministrit të MBUMK që kanë të bëjnë me masat sanitare e fitosanitare (SPS) në mbrojtje të shëndetit të njerëzve, bimëve, kafshëve dhe faunës nën-ujore.

Grafiku i mëposhtëm jep ecurinë e notifikimeve në vite:



Gjithashtu kemi patur disa pyetje/kërkesa nga subjekte të ndryshme të huaja të cilët interesohen për të eksportuar në vendin tonë dhe me ndihmën e institucioneve përkatëse kemi realizuar dhënien e informacioneve korrekte.

Janë kryer notifikimet e programeve të punës 6 mujore të standardeve në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC.

Janë notifikuar në CEN & CENELEC të gjitha Standardet e adoptuara si Standarde Shqiptare si dhe mënyra e tyre e adoptimit (me devijime apo jo) nga DPS.


Ka vazhduar azhurnimi i *database*-it të klientëve të DPS-s, ku evidentohen të gjitha të dhënat e blerësve të standardeve, të cilët kontaktohen për të dhënë të gjitha informacionet rreth standardeve të reja në fuqi që lidhen me fushat e tyre të aktivitetit dhe çdo ndryshim që mund të kenë pësuar ato standarde që janë blerë nga klientët.

Është punuar me arkivën elektronike duke hedhur çdo javë standardet e reja dhe duke hequr gjithë standardet e shfuqizuara.

Sektori i finances, burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese për periudhën Janar – Dhjetor 2008, punën e ka ndërtuar mbi dispozitat ligjore e nënligjore, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brëndëshme të DPS –së si edhe në udhëzimet e herëpashershme të Ministrisë së Financave .

Mbi këtë bazë është bërë planifikimi dhe detajimi i buxhetit të vitit 2008, duke kryer në kohë rakordimet përkatëse me Degën e Thesarit, është nxjerrë bilanci kontabël vjetor i DPS-së për periudhën janar- dhjetor 2007, i cili është dorëzuar brënda afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, është bërë planifikimi i prokurimeve mbështetur në regjistrin e prokurimeve publike, është bërë inventarizimi i pasurisë së DPS, si edhe janë mbajtur të gjitha evidencat kontabile sipas ligjit “Për Kontabilitetin”.

Realizimi i treguesëve të buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2008 paraqitet si më poshtë:



Siç shihet edhe grafikisht kemi një realizim pozitiv të tregueseve të buxhetit për këtë vit.

Artikulli 600 (paga, shpërblime e të tjera shp. personeli) është realizuar në shumën 12.323 mijë lekë kundrejt 13.336 mijë lekë që është plani ose në masën 92%. Kjo tregon për një planifikim të drejtë dhe ndjekje korrekte në realizimin e shpenzimeve për këtë artikull.

Artikulli 601 (kontrib. për sig. shoq. e shënd.) është realizuar në shumën 2.066 mijë lekë nga 2.754 mijë lekë që është plani. Vlen të theksohet se janë ndjekur në vazhdimësi dhe janë derdhur në kohë detyrimet ndaj shtetit për sigurimet shoqërore e shëndetësore, duke aplikuar drejtë për qindjet dhe limitet e miratuara për këtë qëllim. Në mosrealizimin e këtij treguesi ndër të tjera ka influencuar fakti që numri i punonjësve të miratuar sipas strukturës për vitin 2008 u plotësua periodikisht për tre punonjës deri në gusht të këtij viti. Gjithashtu kontributi i llogaritur për muajin dhjetor do të mbyllet në muajin janar të vitit 2009, pasi nuk u krijuan hapsira nga Ministria e Financës që të mbyllet brenda muajit dhjetor të vitit 2008.

Artikulli 602 (mallra e shërbime të tjera) është realizuar në shumën 5.986 mijë lekë nga 6.000 mijë lekë që është plani, ose në masën 99%, çka tregon për një planifikim të drejtë dhe ndjekje me korrektësi të shpenzimeve. Për përdorimin e fondeve për këtë artikull, sipas analizave, është zbatuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël. Nga komisioni i blerjeve është punuar me seriozitet për të zbatuar me korrektësi Udhëzimin Nr 2, datë 18.02.2008, të Agjencisë së Prokurimit Publik, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”

Realizimi i këtij artikulli sipas disa analizave kryesore paraqitet si më poshtë:

Artikull	Analize	përshkrimi	plani vjetor 000/leke	realizimi	
				12 mujori vlefte 000/leke	12 mujori %
602			6.000	5.986	99%
	602/01	kancelari		306	
	602/03	mat.per funks.e pj. te zyr,		399	
	602/2001	en. elektrike		326	
	602/2003	shp. telefonike	-	907	
	602/2010	sherb print e publ		398	
	602/31	karburant		320	
	602/40	Shpenzime udhëtimi	-	1.968	
	602/56	Shp. per miremb.autovet.	-	209	
	602/55	Shp. miremb. paisje tek.		130	
	602/9	Shp. roje godine	-	396	

Gjatë vitit u punua me kujdes që shpenzimi të kryhej për nevojat me të domosdoshme të institucionit. Duke krahasuar me vitin e kaluar disa shpenzime sipas natyrës së tyre shohim se ka rritje në shpenzimet telefonike pasi shpenzimet e internetit në shumën 320 mijë lekë për vitin 2008, në ndryshim nga viti 2007 që u përballuan nga projekti renduan në shpenzimet e institucionit.

Gjithashtu krahesuar me vitin 2007 kemi rritje te shpenzimeve per udhetim e dieta jashte vendit ne masen dy here me shume, shpenzim i cili lidhet me detyrat qe institucioni ka percaktuar per trajnimin e punonjesve. Gjate ketij viti shohim ulje te shpenzimeve te karburantit dhe shpenzimeve te riparimit te autoveturave krahesuar me vitin 2007, ne me shume se 50% c'ka tregon per perdorim me efektivitet te ketyre shpenzimeve.

Janë ndjekur dhe likujduar me korrektësi detyrimet e Institucionit tonë ndaj Organizmave Ndërkombëtarë si ISO; IEC; CEN; CENELEC për rrjedhojë;

Artikulli 605 (transf. korente për org. ndërk), është realizuar 3.814 mijë lekë nga 3.900 mijë lekë që është plani, ose në masën 98%.

Gjate vitit 2008 u be rikonstruksioni i zyrave qe me Urdher nr. 825, date 17.11.2006 dhe Urdher nr. 221, date 06.04.07 te METE kaluan nga kapitali i sh.a “Albkontroll” Durres ne pronesi te Drejtorise se Pergjithshme te Standardizimit.

Per kete qellim u kerkua transferim fondesh nga “paisje zyre” qe ishte planifikuar ne “ rikonstruksion” per shumen 800 mije leke.

Shpenzimet e planifikuara per **artikullin 231**, ne shumen 800 mije leke u realizuan 100%.


Per nje shfrytezim maximal te fondeve te planifikuara gjate vitit 2008 eshte kerkuar prane METE-es dhe eshte bere transferim fondesh kur eshte pare e nevojshme. Keshtu u be transferimi per shumen 500 mije leke nga artikulli 605 ne 602.

Për realizimin e fondeve buxhetore në të gjithë artikujt janë mbajtur në konsiderate limitet mujore të përcaktuara nga METE sipas llogarive dhe janë respektuar këto limite duke bërë edhe kuadraturën çdo muaj me Degën e Thesarit dhe raportuar konform datave te miratuara sipas Udhezimit nr.4 te Ministrise se Financave “ Per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2008” dhe shkreses nr. 679/2, date 21.02.2008 te METE.

Ne rastet kur limitet nuk kane qene te favorshme dhe kane penguar ne shlyerjen ne kohe te detyrimeve ndaj te treteve eshte nderhyre ne METE dhe jane bere transferimet e nevojshme si ne rastin e kerkeses sone per avancim fondesh per shlyerjen e kuotave nderkombetare ne afatet e percaktuara.

Realizimi i të ardhurave dytësore

Është punuar pozitivisht për realizimin e të ardhurave. Ne total ato jane realizuar ne shumen 4.685 mije leke. Per shitjen e standardeve brenda dhe jashte vendit eshte punuar me pergjegjesi e per rrjedhoje të ardhurat nga ky aktivitet janë realizuar në shumën 4.090 mijë lekë ose dy here me shume se ne vitin 2007 . Keto te ardhura jane derdhur teresisht ne buxhetin e shtetit. Jane vjele detyrimet per demet e shkaktuara ne buxhetin e shtetit ne shumen 521 mije leke, shume kjo qe ka kaluar teresisht ne buxhetin e shtetit sipas artikullit “ sekuestrime dhe zhdemtime” Te ardhura te tjera ne shumen 112 mije leke jane arketimet per “garanci dhe sipermarje punimesh” si edhe teprica e arkes date 31.12.2008 qe nuk eshte derdhur ne llogarine e shpenzimeve , por ka kaluar ne llogarine e te ardhurave dhe derdhet ne buxhetin e shtetit.



Realizimi i detyrave në sektorin e burimeve njerëzore

Objekt i punës së sektorit të finances, burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse gjatë vitit 2008, ka qënë menaxhimi i drejtë i burimeve njerëzore.

Ky sektor në zbatim të programeve të trajnimit të Administratës Publike ka realizuar angazhimin e punonjësve për tema të cilat kanë qënë me interes për kualifikimin e tyre. Gjatë vitit 2008 u plotësua struktura e DPS me numurin e miratuar sipas Urdhërit nr. 75, datë 11.06.2008 të Kryeministrit. Për këtë qëllim u angazhuan totalisht Drejtoria e Integritit dhe ajo e Standardeve për të rekrutuar punonjës të kualifikuar.

Punonjësve ju është bërë prezent çdo ndryshim në VKM që lidhet me shpërblimin e tyre, duke i reflektuar këto ndryshime në kontratat individuale të punës.

U bë vlerësimi i punës për periudhën një vjeçare të vitit 2008 për çdo punonjës, që u bë pjesë e dosjes personale të gjithësecilit.

Gjatë këtij viti u punua me regjistrin themeltar të punonjësve ku u hodhën të dhënat për çdo punonjës sipas strukturës aktuale. Po kështu u krijuan dosjet personale për çdo punonjës, duke bërë edhe rifreskime për dokumenta të vecanta të tyre.

Funksionimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në DPS për vitin 2008

Në zbatim të Politikës dhe Objektivave të cilësisë për vitin 2008 dhe plotësimin e kushteve për antarësim me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC, detyra kryesore në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ishte përmirësimi i vazhdueshëm i tij dhe përafrimi i dokumentacionit tonë të cilësisë me kërkesat e shprehura në Rregulloren e Brendshme të CEN/CENELEC.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 9870, date 04.02.2008 “Për Standardizimin”, lindi nevoja për ripunimin e të gjitha procedurave në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e përcaktuara në të.

Me adoptimin dhe miratimin e standardit ISO 9001:2008, në mënyrë që të reflektojë ndryshimet në kërkesat e këtij versioni, është rishikuar i gjithë Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë i cili më parë i referohej ISO 9001:2000.

Në të gjitha procedurat e hartuara ose të ripunuara janë reflektuar kërkesat e ligjit “Për Standardizimin”, akteveënligjore në të cilat mbështetet puna e DPS, si dhe Rregulloreve të Brendshme të CEN/CENELEC.

Për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të SMC të DPS janë realizuar auditime të brendshme, përditësuar lista e dokumentacionit duke reflektuar çdo ndryshim të dokumentacionit, lista e shpërndarjes së dokumentacionit si dhe ndjekja e zgjidhjes së tyre, janë ndjekur veprimet korrigjuese të ndërmarra si dhe matja e efektivitetit të tyre dhe realizuar mbledhje të Rishikimit të Menaxhimit.

DPS vazhdon të mbetet i vetmi institucion publik i çertifikuar sipas standardit ISO 9001:2000.